



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

**Kabineti i Kryetarit të Komunës së Prizrenit**  
**Drejtoria për Ekonomi e Financa**  
**Datë: 31 Maj 2021**  
**Prizren**

**DËGJIMI I KATËRT PUBLIK PËR KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE**  
**(KAB) 2022-2024**  
**“Takimi i dytë me qytetarët”.**

**PROCESVERBAL**

**Debati i katërt (IV) publik për pranimin e propozimeve dhe kërkesave eventuale për buxhet, projekte dhe shërbimet komunale për vitin e ardhshëm 2022 – 2024. Dëgjimi i katërt dhe i fundit mbahet më qytetarët komunës sonë**

Komuna e Prizrenit organizon katër dëgjime publike lidhur me Kornizën Afatmesme Buxhetore 2022-2024.

Në këto dëgjime mëtojmë të marrim opinionin e qytetarëve për projektet vijuese të komunës sonë, shërbimet komunale dhe kërkesat tjera eventuale.

**Vazhdojmë më dëgjime publike për pranimin e propozimeve dhe kërkesave të qytetarëve lidhur me projektet dhe shërbimet komunale!**

Më 31 maj (e hënë), në ora 17:00 në sallën e Kuvendit Komunal do të mbahet mbledhja e katërt për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2022-2024, ku tema e këtij dëgjimi publik është “**Takimi i dytë me qytetarët**”.

Për shkak të situatës pandemike, pjesëmarrja në këto takime do të jetë e kufizuar sipas distancës dhe hapësirës në sallë, ndërkaq për të mundësuar sa më shumë pjesëmarrje dhe gjithëpërfshirje, Komuna e Prizrenit këto dëgjime publike do t'i organizojë edhe në formën “online” përmes aplikacionit ZOOM, nëpërmjet linkut:

<https://us02web.zoom.us/j/89806593475>

Meeting ID: 898 0659 3475

Informacionet më të hollësishme në lidhje me dëgjimet publike dhe linqet për pjesëmarrje nëpërmjet platformës ZOOM mund të gjeni në:

Për gjuhën shqipe: <https://kk.rks-gov.net/.../04/Degjime-publike-KAB.pdf...>

Për gjuhën turke: <https://kk.rks-gov.net/.../26/2021/04/ORTA-VADELI-KAB.pdf...>

Për gjuhën srb/bosh.: <https://kk.rks-gov.net/.../JAVNE-DEBATE-O-SREDNJOROCNOM...>

Qytetarët dhe të tjerët të interesuar, informacione më të përimtuara për dëgjimet publike, linqet për pjesëmarrje përmes platformës ZOOM, orën dhe ditën e mbajtjes së dëgjimeve, në të gjitha gjuhët zyrtare i kemi bërë publike kohë më parë, në Ueb faqe të komunës, Facebook, Instagram, YouTybe, TV- lokale, Radio Lokale, etj...

**Të ftuar:**

- Përfaqësuesit e Kuvendit të Komunës së Prizrenit,
- Qytetarët,
- Organizatat Ndërkombëtare,
- Përfaqësuesit e OJQ-ve të Komunës së Prizrenit,
- Përfaqësuesit e shoqatave të bizneseve të Komunës së Prizrenit,
- Mediet lokale të Komunës së Prizrenit.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



# Cila është kërkesa juaj për **Komunën ?**

Komuna e Prizrenit organizon dëgjime publike lidhur me  
**Kornizën Afatmesme Buxhetore 2022-2024.**

Në këto dëgjime ftohen:

- Përfaqësuesit e Kuvendit të Komunës së Prizrenit,
- Qytetarët,
- Organizatat Ndërkombëtare,
- Përfaqësuesit e OJQ-ve të Komunës së Prizrenit,
- Përfaqësuesit e shoqatave të bizneseve të Komunës së Prizrenit,
- Mediat lokale të Komunës së Prizrenit.



Për shkak të situatës pandemike, pjesëmarrja në këto takime do të jetë e kufizuar.  
Për të mundësuar sa më shumë pjesëmarrje dhe gjithëpërfshirje, Komuna e Prizrenit këto  
dëgjime publike do t'i organizojë edhe në formën "online" përmes aplikacionit ZOOM.  
Agjenden e degjimeve mund ta gjeni ne webfaqen e komunës <https://kk.rks-gov.net/prizren/>

Dëgjimin e katërt publik dhe të fundit për këtë seri të dëgjimeve e moderoi drejtoresha për Ekonomi e Financa znj. Leonora Çerreti, e cila fillimisht prezantoi planifikimet dhe parashikimet buxhetore të komunës sonë për vitin 2022-2024

Buxheti për vitin 2022 do të jetë 49.455.755.00 euro, 3.5 %, rritje krahasuar më vitin paraprak.

Linku i prezantimit: <https://www.youtube.com/watch?v=FJhqiYGvYko>

Pas prezantimit të planifikimit të buxhetit për vitin vijues, drejtoresha znj. Leonorë Çerreti hap diskutimin më të pranishmit në sallë dhe ata të cilët përcillnin debatin online.

**Bashkim Gashi**

Monumenti me i vizituar është Kalaja e Prizrenit, një problem i madh është rruga deri të kalaja, rruga është e dëmtuar, nuk kanalizim per ujera atmosferik, nuk ka as anësore për mbajtje me duar etj.

Duhet te behet një projekt më shoqatën e arkitekteve për rrugën nga Qendra Evropa ne qytet deri ne kala. Te behet kanalizimi për ujërat atmosferik dhe ujërat nëntokësor ngase dimrit ka vështirësi të mëdha, kërkoj të vendosen ulëse përgjatë rrugës ku është e mundur.

E kam edhe një pyetje per Muzeun e Filigranit, a është në buxhet i parapare?

**Leonora Çerreti**

Kërkesat tuaja do t'i përcjellim, te të gjitha drejtoritë përkatëse dhe gjate hartimit përfundimtar do të shohim se sa do të mund të përfshijmë në buxhet. Do të hartojmë një raport përfundimtar dhe do ta publikojmë se sa kërkesa të qytetarëve janë përfshirë ne buxhet

**Kryetar i fshatit Arbanas**

Rrethoja e shkollës në fshatin Arbanas duhet te rregullohet, ngase ka qen endacak dhe janë të rrezikuar nxënësit.

E dyta një kanal për ujitjen e tokave bujqësore, janë rreth 300 hektar tokë që mund të ujitjen. Deri më sot nuk u realizuar ky projekt edhe pse kemi kërkuar vite me pare.

Duhet të rregullohen edhe rrugët fushore, të shtrohen me zhavorr dhe të hapen ngase janë mbushë me baroja.

Ne drejtim te fshatit Zojz është një rruge, por në atë rrugë duhet te ndërtohet një urë për t'u bërë e kalueshme.

Te stadium kërkojmë të vendosen reflektor për ndriçim.

Të ndërtohet edhe një Qendër Rinore ne fshat?

Falënderoj komunën per investimet e realizuara deri tani në fshatin tonë.

Ymer Korena: lagja “Jeta e Re”

Nuk kemi rrugë dalëse, rruge te asfaltuar apo me kupëza betoni, nxënësit e lagjes sonë po hasin në probleme, po lagen dhe është shumë me balte kur bien shi, plot me gropa është rruga dhe skaj hekurudhës, ndaj apeloj që ta zgjidhni këtë problem.

Ramadan Kolukaj - online

Pse Vërmica është ndër fshatrat e pakët që nuk ka ndriçim publik?

Leonor Cerreti

Ndriçimin publik sa kam info unë, jemi duke e rregulluar

Adnan Demiri

Ne fshatin Jabllanicë ka nis ndërtimi i një stadiumi e nuk po përfundon që disa vite?  
Problem është edhe ndriçimi publik, kur do te rregullohen këta probleme?

Besnik Beqiri fshati Gornje Sello

Kur do rregullohet rruga në fshatin tone, e kemi rregulluar pak me iniciativë tonën por presim nga komuna a do të na ndihmoj ne rregullimin e rrugës?

Simon Veseli fshati Shpinadi

Prej 2017 e deri më sot Shpinadija ka përfituar vetëm një rrugice, kemi nevojë edhe për pesë rrugica tjera të shtrohen me kupëza më gjatësi deri 350 m<sup>2</sup>

Rruga ne lagjen Qollaku, Spaqi, Veseli etj.

Kemi kërkesa edhe për një ure fushore dhe hapjen e kanaleve te ujit per ujitjen e tokave bujqësore.

Ne fshat kemi do varreza që duhet të rrethohen dhe kërkojmë nga komuna që ti rrethojë, Jemi 169 familje, kemi nevojë për një Shtëpi Kulture rreth 200m<sup>2</sup>, jo me te madhe për nevojat e qytetarëve dhe te të rinjve, pronën e sigurojmë ne fshataret.

Linda Namlegjiu - online

Kërkojmë nga DKA-a, që të shtohet në kurrikulë të arsimit fillor dhe të mesëm aktivitete për mbrojtjen e mjedisit dhe procesin e riciklimit

Salajdin Xhoxh lagja “Petrovë”

Kërkojmë renovimin e shkollës, nje park duhet ta ndërtoni të tri ndërtesat kolektive, afër shkollës Loyola

Një përroske të vogël e kemi dhe kërkojmë rregullimin e shtratit të saj, si ne Landovice, Çerdhja dhe Shtëpia e Kulturës për Boshnjak nuk kanë rrethoja dhe qentë endacak po e rrezikojnë.

Bashkim Krasniqi

Me intereson se ç’far vendimi do merrni për qeshjet e parkingjeve, ne te gjitha lagjet dhe rrugët e qytetit, kemi vështirësi të mëdha sidomos lagja te Qylhani është shume keq. Jemi ne pritje te zgjidhjes se këtij problemi. Edhe kontejnerët e mbeturinave janë vendose gabimisht ne lagjen tone. Kam bere kërkesë edhe ne higjiene po asgjë deri sot.

Arhim Ajazi

Sa i përket stadiumit në Serbic, ky problem do zgjidhet.

Për ndriçim publik, ju duhet t’i drejtoheni DSHP-së.

Stadiumi në Jabllanice është vonuar ngase ju keni kërkuar që të behet revidimi i projektit dhe besoj se së shpejt do ta sjellim barin sintetik nga Turqia, besoj se per 30 dite ky projekt do të përfundoj.

Sa i përket Shpinadisë për Shtëpi të Kulturës ju lus të përsërisni kërkesën dhe ne do të mundohemi ta vendosim ne buxhet te vitit 2022

Qendra boshnjake do të rrethohet dhe do rregullohet edhe oborri, do të mbrohet nga ndërhyrjet nga jashtë.

Per fushat e sportit afër shkollës “Leke Dukagjini”, firma duhet t’i ruaje ato objekte, unë nesër do ta takoj firmën dhe do kërkoj qe ta ruaje objektin deri në përfundim te projektit.

Karafil Axhillari

Sa buxhet parashihet per turizmin malor në Prizren, gjegjësisht në fshatin Struzhe?

E kemi një pilot projekt per disa bujtina në Struzhë, deri ku ka mbërri ky projekt dhe a do të vazhdoj?

Në Sgtruzhë kërkojmë edhe një terren sportiv atje.

Ne lagjen “Petrove”, në paralelen e Petroves te hapet një klase për parashkolloret e kësaj lagje.

Shukri Quni

Rruga “Besim Shala”, në fshatin Nashec nuk ka kanalizim dhe është shume keq, duhet komuna ta rregullojë. Po ashtu kërkohet edhe një trotuar nga Prizreni deri në Nashec.

Leonora Çerreti

Të nderuar qytetar dhe pjesëmarrës online në këtë dëgjim ju falënderoj për kontributin dhe besoj se kërkesat tuaja për projekte do t'i përfshijmë në buxhet viteve në vijim.

Faleminderit